



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2018

V E N D I M

Nr. 54, Datë 09/02/2018

Mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur me postë ankesa nr. 5, datë 18.01.2017, e shoqatës “SONCE”, me përfaqësues z. V. S., shtetas shqiptar me kombësi maqedonase, ku pretendohet diskriminim për shkak të etnisë, nga ana e Ministrit të Punëve të Jashtme, z. D. B.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Sipas shpjegimeve të dhëna nga z. V. S., Kryetar i Shoqatës “Sonce”, me seli në Korçë, sqarohet se: *“Ministri i Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, z. Ditmir Bushati, në një intervistë të dhënë për televizionin Top Channel, më datën 09.01.2017, duke folur për situatën në Maqedoni të popullit maqedonas, iu referua me termin “sllavo maqedonas”.*

Sipas tij, *“përdorimi i termit sllavo-maqedonas është një fyerja e rëndë për popullin maqedonas në mbarë botën, si dhe për komunitetin maqedonas në Republikën e Shqipërisë, i cili është i njohur zyrtarisht nga shteti shqiptar”,* për këtë arsye ai pretendon se kjo deklaratë, është e papërshtatshme dhe ofenduese.

Për sa më sipër, z. V. S., kërkon që “Ministri i Punëve të Jashtme z. D. B. të kërkojë ndjesë publike për përdorimin e termit sllavo-maqedonas dhe t’mos përdorë terma ofendues për popullin maqedonas”.

Mbështetur në dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe në kërkesat e përcaktuara në formularin e aplikimit, në rastin kur ankesa paraqitet nga një organizatë me interesa legjitime, asaj duhet t’i bashkëlidhet kopja e vendimit të gjykatës për krijimin e organizatës ose aktin e prokurës së posaçme, për të përfaqësuar personin ose grupin e personave.

Nga shqyrtimi i dosjes rezulton se është paraqitur në cilësinë e provës, vendimin nr. 2986 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që vërteton regjistrimin e Shoqatës “Sonce”, si person juridik”, kryetar i së cilës është z. V. S., por nuk është depozituar asnjë dokument identifikues i përfaqësuesit. Për këtë arsye z. V. S. është kontaktuar në telefon, nga inspektorëi i çështjes, në numrin e kontaktit të lëshuar prej tij, në formularin e aplikimit¹ dhe i është kërkuar që të plotësonte ankesën duke vënë në dispozicion një kopje të dokumentit të tij të identifikimit, të cilin mund ta dërgonte përmes shërbimit postar, në adresën e Komisionerit, ose në adresën elektronike: info@kmd.al. Aktualisht, ankuesi, nuk ka depozituar asnjë dokument identifikues.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se ankesa nr. 5, datë 18.01.2017, e shoqatës “SONCE”, me përfaqësues z. V. S., shtetas shqiptar me kombësi maqedonase, ku pretendohet diskriminim për shkak të etnisë, nga ana e Ministrisë të Punëve të Jashtme, z. D. B., nga pikëpamja formale, nuk plotëson kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma b): “1. Komisioneri ka kompetencë: a) b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi” dhe në nenin 33, pika 4, gërma ç): “Ankesa nuk pranohet nëse: a)..... b)....., c)....., ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;”

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 3, 20, 21, pika 1, neni 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma ç) të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

¹ Z. V. S. është kontaktuar në numrin 0672046050, më datë 19.01.2017

V E N D O S I:

- 1.** Mospranimin e ankesës nr. 5, datë 18.01.2017, e shoqatës “SONCE”, me përfaqësues z. V. S., pasi nuk plotëson kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
- 2.** Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, brenda afateve të parashikuara me ligj.

KOMISIONERI

IRMA BARAKU

Fusha- te mira dhe sherbime
Shkak - etnia

